



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 204, Datë 04.12.2020

“MBI  
FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “RREGULLORES PËR  
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT TË  
DEPOZITIMIT TË GAZIT NATYOR”.

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 16; nenit 29, pika 2, të Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 04.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 127/3 prot, datë 02.12.2020, e përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullores për përcaktimin e kriterëve për ushtrimin e aktivitetit të depozitimit të gazit natyror”,

**Konstatoi se:**

- Drejtoritë Teknike kanë draftuar Rregulloren për depozitimin e gazit natyror, për t’u siguruar palëve të interesuara të industrisë së gazit, Aktin rregullator që përcakton kriteret për ushtrimin e aktivitetit nga të licencuarit në sektorin e gazit natyror.
- Ky dokument do të sigurojë një pasqyrë më të qartë të modaliteteve të ushtrimit të këtij aktiviteti vecanërisht për vend-depozitimin e gazit në depozitimet kripore (Diapiret e dumresë), në vendburimet e shteruara të naftës (vendburimet; Cakran-Mollaj, Ballsh-Hekal, Visokë, Patos, Gorisht-Kocul, Marinëz), dhe vendburimet e gazit (Divjakë, Frakull, Povelçë, Ballaj-Kryevidh, Panaja, Finiq-Kranë), në shtresat ujore (Aquifaire) atje ku mund të identifikohen, në Republikën e Shqipërisë.
- Kjo Rregullore paraqet kriteret që ERE planifikon të përdorë kur merret parasysh regjimi më i përshtatshëm i aksesit të palëve të treta ose përjashtimi për depozitimin e gazit në Shqipëri në të ardhmen.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullores për përcaktimin e kriterëve për ushtrimin e aktivitetit të depozitimit të gazit natyror”.

2. Drejtoria e Gazit Natyror, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**